

"Liria ka Emër" fton
qytetarët në "Marshin
për Liri" më 12 shtator

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

'LIRIA KA EMËR', AKSION PARA EULEX-it PËR ISH-KRERËT E UÇK-së: NË EMËR TË POPULLIT, SHPALLENI TË PAFAJSHËM!

FAQE 4-5



Aktivistë të platformës qytetare "Liria ka Emër" kanë zhvilluar të martën një aktivitet simbolik para objektit të EULEX-it në Prishtinë, ku ndodhet edhe Zyra e Dhomave të Specializuara, duke përcjellë

mesazhin: "Në emër të popullit, shpalleni të pafajshëm!". Përmes këtij aktiviteti platforma ka kërkuar drejtësi dhe liri për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep

Selimin, ndërsa ka bërë thirrje që në përfundim të procesit gjyqësor të mos harrohet konteksti historik i luftës çlirimtare të Kosovës dhe sakrificat mbi të cilën është ndërtuar liria e vendit

OPINION

TRAJTIMI I MLLADIOIT NË SERBI:
IRONI E MADHE, PO, ÇUDI JO! F. 7

Shkruan:
Valon MURATI



AKTUALE



THELLOHEN PËRÇARJET NË LDK,
PËRPLASEN ABDËXHUKU, HOTI DHE
BAJRAMI F. 7


XHELAL SVEÇLA DËNOHET
ME NJË VIT BURGIM ME KUSHT
PËR HEDHJEN E GAZIT LOTSJELLËS
NË KUVEND F. 7

EKONOMI



BQK-ja DHE SEKTORI BANKAR
VAZHDOJNË PËRGATITJET PËR
INTEGRIMIN NË SEPA F. 8

SPORT



BALLKANI PËRFORÇON MBROJTJEN
ME LENDRIT SHALËN F. 11



A DO TË KONSTITUOHET SOT
KUVENDI I KOSOVËS? F. 4

PUBLIKOHEN
REZULTATET E
PISA 2025,
KOSOVA MBETET
NËN MESATAREN
E OECD-së F. 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

UDHËHEQËSIT E BE-SË DËNOJNË MADHËRIMIN E MLLADIQIT NË BEOGRAD

BRUKSEL, 8 SHTATOR - Kryetarja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, dhe kryetari i Këshillit Evropian, Antonio Costa, reagues së bashku, duke i cilësuar “tronditëse” pamjet nga Beogradi gjatë varrimit të Ratko Mlladiqit, ish-komandant i Ushtrisë së Republikës Sërpska, i dënuar nga Tribunali i Hagës për gjenocid dhe krime të tjera lufte në Bosnjë-Hercegovinë. “Elementet e mbështetjes zyrtare, si dhe prania e disa zyrtarëve të lartë serbë në varrim, janë thellësisht dëshpëruese. Ato tregojnë dështimin për t’u përballur me kapitullin e errët të historisë së vonshme evropiane, dhe janë në kundërshtim me vlerat mbi të cilat bazohet rruga e Serbisë drejt Bashkimit Evropian”, theksuan në një deklaratë të përbashkët liderët e institucioneve kryesore evropiane. Duke rikujtuar se Ratko Mlladiq ishte i dënuar i luftës, përgjegjës për gjenocid, krime lufte dhe

krime kundër njerëzimit, Von der Leyen dhe Costa thanë se mendimet e tyre janë me të gjitha viktimat e krimeve të kryera në vendet e ish-Jugosllavisë. Kjo deklaratë dënuese e dy udhëheqësve të BE-së vjen një ditë pasi zëdhënësja kryesore e KE-së, Paula Pinho, deklaroi se Mlladiqi “nuk u varros me nderime shtetërore” në Serbi. Deklaratën e zëdhënësës e dënuan një numër i madh aktorësh politikë në Bruksel dhe në rajon. Mlladiq u varros më 7 shtator në Beograd, me nderime ushtarake dhe shtetërore. Ai vdiq më 27 gusht në Hagë derisa po vuante dënimin me burgim të përjetshëm, ndërsa u varros në varrezat Topçider në Beograd. Ceremonia e varrimit u shoqërua me të shtëna nderi dhe fjalime lamtumire, në të cilat u madhërua e kaluara e tij gjatë luftës. Në prani të pjesëtarëve të Ushtrisë së Serbisë,



udhëheqësve politikë të Republikës Sërpska, pjesëtarëve të Kishës Ortodokse Serbe dhe zyrtarëve të Serbisë, të pranishmit brohoritën emrin e

Mlladiqit dhe e përcollën arkivolin e tij me duartrokitje. Përkujtimi, shërbesa fetare dhe varrimi në Beograd u shoqëruan me paralajmërim

nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës se madhërimi i kriminelëve të dënuar të luftës është i papranueshëm.

RUSIA GODET KIEVIN DISA ORË PASI TË DËRGUARIT AMERIKANË U LARGUAN NGA KRYEQYTETI UKRAINAS

KIEV, 8 SHTATOR - Rusia e goditi kryeqytetin ukrainas me raketa balistike, duke vlarë të paktën dy persona, në një sulm të madh disa orë pasi të dërguarit e Shtëpisë së Bardhë u larguan nga Kievi, në një kohë kur përpjekjet për rifillimin e negociatave të paqes janë shtuar. Sulmi i 8 shtatorit erdhi pas një pezullimi në sulmet pothuajse të përditshme, të cilat kanë nënvizuar synimin e Rusisë për ta vazhduar luftën e saj mbi 4-vjeçare kundër Ukrainës pavarësisht prej humbjeve astronomike. Punonjësit e emergjencave nxorën trupa nga rrënojat në një lagje të Kievit, ndërsa zjarrfikësit luftuan për t’i shuar zjarret e shkaktuara nga sulmi, i cili përfshiu edhe dronë me motorë aeroplanësh - një armë e fuqishme kundër së cilës Ukraina ka pasur vështirësi të mbrohet. Të paktën 10 persona u plagosën, njoftuan autoritetet e emergjencave. Sulmi rus përfshiu dhjetëra raketa balistike dhe lundruese si dhe më shumë se 160 dronë gjatë natës, tha ushtria ukrainase. Gjatë javës së fundit Rusia ka kryer sulme pothuajse të përditshme ndaj Ukrainës. Aftësia e Ukrainës për t’u mbrojtur nga këto sulme është



kufizuar rëndë për shkak të mungesës së penguesve të raketave, mbi të gjitha të sistemeve Patriot të prodhuara nga ShBA-ja. Sulmi ndodhi disa orë pasi të dërguarit amerikanë, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, u larguan nga Kievi, pas takimeve me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky dhe zyrtarë të tjerë. Para Kievit, dyshja kishte vizituar Moskën, ku zhvilloi bisedime me presidentin Vladimir Putin. Përpjekjet e ShBA-së për t’i shtyrë përpara negociatat e paqes kanë qenë të pezulluara

muajt e fundit, pasi Uashingtoni i ka dhënë përparësi luftës kundër Iranit, e cila tani ka hyrë në muajin e gjashtë. Ministri i Jashtëm ukrainas, Andriy Sybiha, u bëri thirrje aleatëve të Kievit “të veprojnë dhe ta rrisin presionin ndaj agresorit”. Ministria ruse e Mbrojtjes tha se sulmi kishte në shënjestër objekte të mbrojtjes dhe të logjistikës ushtarake ukrainase. Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Ukrainë, Katarina Mathernova, tha se e kaloi natën në një strehimore, ndërsa “Kievi po shpërthente dhe digjej” gjatë

sulmit rus. “Ajo që ndodhi në Kiev mbrëmë ishte ferr”, shkroi ajo në X. “Nuk do t’ia uroja askujt që jeton në paqe dhe bie në gjumë i sigurt në shtratin e vet”. Fundjava shënoi herën e parë që Witkoff dhe Kushner udhëtuan në Kiev për bisedime. Witkoff është takuar me Putinin tetë herë që nga fillimi i vitit 2025. Pas takimit me Zelenskyn, Witkoff i përshkroi diskutimet si konstruktive dhe tha se Uashingtoni kishte dëgjuar “ide të reja” nga Moska. Kushner tha se Shtetet e Bashkuara po punonin për një “paketë më të gjerë paqeje”.

Zelensky, nga ana e tij, i quajti diskutimet e tij me amerikanët “shumë substanciale” dhe tha se Ukraina ishte e gatshme të ecte përpara drejt bisedimeve trepalëshe që do ta përfshinin Kievin, Uashingtonin dhe Moskën. Këshilltarët për sigurinë kombëtare të Britanisë, Francës dhe Gjermanisë gjithashtu morën pjesë në një pjesë të diskutimeve në Kiev. Ukraina ka sinjalizuar se është e gatshme të zhvillojë një tjetër takim me zyrtarë rusë dhe amerikanë, diçka që nuk ka ndodhur që nga viti i kaluar. Kremli, megjithatë, nuk ka dhënë asnjë shenjë se ka zbutur qëndrimin e tij të ashpër lidhur me synimet e luftës. Në komentet për gazetarët pas takimeve të 5 shtatorit me Putinin, këshilltari i Kremlinit për politikën e jashtme, Yury Ushakov, tha se Rusia do t’i vazhdojë përpjekjet për të “eliminuar”, siç u shpreh, “shkaqet rrënjësore” të konfliktit. “Shkaqet rrënjësore” është një term që përfshin një sërë ankesash dhe pretendimesh ruse që datojnë që para pushtimit të vitit 2022, përfshirë pretendimin se Zelensky nuk është president legjitim dhe se qeveria ukrainase po shtypte rusishtfolësit vendas në Ukrainë.

PUBLIKOHEN REZULTATET E PISA 2025, KOSOVA MBETET NËN MESATAREN E OECD-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Janë publikuar rezultatet e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) 2025, ku Kosova ka marrë pjesë me 6 632 nxënës 15-vjeçarë nga 213 shkolla. Sipas rezultateve, performanca mesatare e nxënësve të Kosovës në shkencë është 357 pikë, ndërsa në lexim 340 pikë. Krahasuar me PISA 2022, rezultati në shkencë ka mbetur në të njëjtin nivel, ndërsa në lexim ka shënuar një rënie të lehtë nga 342 në 340 pikë. Në matematikë Kosova ka arritur 350 pikë, që është pesë pikë më pak se në vitin 2022. Ndërkaq, në fushën e zgjidhjeve kompjuterike, rezultati mesatar ishte 359 pikë. Rezultatet në të katër treguesit kryesorë të performancës mbeten nën mesataren e vendeve anëtare të OECD-së.

Vajzat më mirë se djemtë

Në PISA 2025 vajzat kanë shënuar rezultate më të larta se djemtë në të tria fushat kryesore të vlerësimit. Në shkencë vajzat kanë marrë 366 pikë, ndërsa djemtë 347 pikë, me një diferencë prej 19 pikësh. Në lexim diferenca është edhe më e madhe: vajzat kanë arritur 358 pikë, krahasuar me 322 pikë të djemve. Në matematikë rezultatet janë pothuajse të barabarta, me 351 pikë për vajzat dhe 350 për djemtë.

Vetëm një pjesë e nxënësve arrijnë nivelin bazë

Gjetjet e PISA 2025 tregojnë se vetëm rreth 21 për qind e nxënësve në Kosovë kanë arritur të paktën Nivelin 2 në shkencë, ndërsa në matematikë kjo përqindje është 15 për qind dhe në lexim rreth 16 për qind. Në të njëjtën kohë numri i nxënësve që arrijnë nivelet më të larta të performancës mbetet shumë i vogël. Për këtë arsye rekomandohet një qasje e dyfishtë: mbështetje më e madhe për nxënësit me rezultate të ulëta dhe programe të veçanta për zhvillimin e potencialit të nxënësve me performancë të lartë.

Mungesat në shkollë, një tjetër shqetësim

Raporti evidenton edhe problemin e vijueshmërisë në shkollë. Rreth 54 për qind e nxënësve kanë raportuar se kanë munguar të paktën një ditë gjatë dy javëve para testit, ndërsa 56 për qind kanë munguar të paktën në një orë mësimore. Sipas gjetjeve, kjo tregon nevojën për mekanizma më të mirë të monitorimit të vijueshmërisë dhe bashkëpunim më të strukturuar ndërmjet shkollave, prindërve dhe nxënësve. Raporti rekomandon forcimin e të nxënësve bazë në matematikë, shkencë dhe lexim, zhvillimin e



mësimdhënies përmes zgjidhjes së problemeve dhe situatave reale, forcimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, përdorimin më efektiv të teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale, si dhe përmirësimin e klimës së të nxënësve dhe disiplinës pozitive. “Forcimin e të nxënësve bazë në matematikë, shkencë dhe lexim, me fokus të veçantë te nxënësve që nuk arrijnë Nivelin 2 të aftësive; Zhvillimin e mësimdhënies së bazuar në zgjidhjen e problemeve, situata reale, mendimin kritik dhe aplikimin praktik të njohurive; Krijimin e programeve për nxënësit me performancë të lartë, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e talentit në shkencë, matematikë dhe lexim; Shfrytëzimin e

reziliencës akademike si praktikë pozitive, duke identifikuar shkollat, mësuesit dhe praktikantët që ndihmojnë nxënësit e pafavorizuar të arrijnë rezultate të larta; Forcimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, veçanërisht në pedagogjinë e orientuar drejt kompetencave, vlerësimit formativ, diferencimit të mësimit dhe menaxhimit të klasës; Zhvillimin e politikave për përdorimin efektiv të teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale-së, duke kaluar nga përdorimi thjesht instrumental drejt përdorimit të tyre për kërkim, analizë, verifikim dhe krijim të pavarur të njohurive; Forcimin e bashkëpunimit shkollë-familje, veçanërisht për mbështetjen e nxënësve,

vijueshmërinë dhe krijimin e shprehive të qëndrueshme të të nxënësve; Përmirësimin e klimës së të nxënësve dhe disiplinës pozitive, duke krijuar klasa më të qeta, gjithëpërfshirëse dhe të fokusuara në procesin mësimor; Monitorimin e vijueshmërisë së nxënësve dhe ndërmarrja e masave të hershme për nxënësit me mungesa të shpeshta”, thuhet në këtë raport. Ministria e Arsimit dhe Shkencës pritet t’i analizojë gjetjet dhe të dhënat e PISA 2025, ndërsa raporti do të shërbejë si referencë për ndërhyrjet sistematike, metodologjike dhe pedagogjike që do të përfshihen në Strategjinë e re të Arsimit.

MINISTRIA E DREJTËSISË NIS HARTIMIN E STRATEGJISË SË RE KUNDËR DHUNËS

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Në Ministrinë e Drejtësisë është mbajtur mbledhja e parë e grupit punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore 2027 - 2031. Koordinatorja kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, Donika Gërvalla, ka thënë se strategjia e re duhet të jetë më e guximshme dhe t’i adresojë sfidat konkrete në parandalimin dhe luftimin e dhunës. “Për strategjinë 2027-2031 duhet të jemi të guximshëm. Duhet të adresojmë tema që sot mund të na duken të vështira”, ka thënë Gërvalla. Ajo ka vlerësuar kontributin e shoqërisë civile, organizatave dhe individëve që, sipas saj, për vite me radhë kanë



kërkuar trajtimin e dhunës me seriozitet nga institucionet. Gërvalla ka thënë se përvoja në luftimin e dhunës në familje ka treguar se krijimi i mekanizmave parandalues, mbrojtës dhe ndëshkues jep rezultate. Ajo ka

theksuar se rritja e numrit të rasteve të raportuara nuk nënkupton domosdoshmërisht rritje të dhunës, por mund të jetë edhe rezultat i ndërgjegjësimit më të madh, fushatave dhe angazhimit të institucioneve, në

mënyrë që viktimat të kenë më shumë besim dhe guxim për të raportuar. “Puna në këtë fushë nuk prek vetëm gratë. Ajo prek fëmijët, familjet dhe shoqërinë në tërësi. Prandaj, qasja jonë duhet të jetë më e gjerë, më

gjithëpërfshirëse dhe e fokusuar në mbrojtjen e çdo personi që preket nga dhuna”, është shprehur ajo. Sipas Gërvallës, dhuna është problem ndërkombëtar dhe jo fenomen vetëm i Kosovës apo i shqiptarëve, por përgjegjësia e institucioneve është që t’i përdorin të gjithë mekanizmat në dispozicion për ta luftuar atë. Në takimin e parë të grupit punues janë diskutuar gjetjet nga analiza e strategjisë aktuale si dhe objektivat strategjike dhe specifike që pritet të përfshihen në strategjinë e re. Gërvalla ka thënë se puna do të vazhdojë në takimet e ardhshme, me synimin që Strategjia Kombëtare 2027-2031 të mos mbetet vetëm dokument me objektiva, por të sjellë hapa konkretë për parandalimin, mbrojtjen dhe luftimin e dhunës.



A DO TË KONSTITUOHET SOT KUVENDI I KOSOVËS?

Sot, e mërkurë, do të vazhdojë seanca konstituive e legjislaturës së njëmbëdhjetë të Kuvendit të Kosovës. Deputetët janë thirrur që nga ora 11:00 të jenë të pranishëm në sallën plenare, në të cilën pritet të votohet për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë konfirmuar pjesëmarrjen në seancën konstituive. Ndërkaq, Aleanca nuk do të marrë pjesë. Sipas kësaj partie, për shkak të mosrespektimit të afateve kushtetuese nga partia në pushtet, tashmë janë konsumuar mandatet e deputetëve

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Deputetët e zgjedhur të legjislaturës së njëmbëdhjetë sot (e mërkurë) do të mbledhen për vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës në përpjekje për t'i formuar institucionet e reja të vendit pas zgjedhjeve të qershorit dhe për t'i dhënë fund krizës pothuajse dyvjeçare politike.

Lëvizja Vetëvendosje (LV), Partia Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë konfirmuar pjesëmarrjen në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, nuk ka treguar nëse do ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit në vazhdimin e seancës konstituive më 9 shtator. "Nesër e kanë thirrur seancën e Kuvendit. Do të jemi aty", u përgjigj para gazetarëve Kurti të

martën.

Në seancat e 6 dhe 8 gushtit, Kurti kishte kërkuar kohë shtesë nga kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, deri në arritjen e një marrëveshje politike për çështjen e presidentit. Që atëherë Kuvendi ka mbetur pa e përmbyllur konstituimin e legjislaturës së njëmbëdhjetë, duke ngecur te pika e zgjedhjes së kryetarit dhe ajo e nënkryetarëve të Kuvendit. Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, pasi ka treguar se do të marrin pjesë në seancën konstituive të Kuvendit më 9 shtator, nuk ka e ka përjashtuar mundësinë që edhe kjo seancë të jetë lojë politike e Lëvizjes Vetëvendosje. Hamza ka thënë se gjatë diskutimeve të zhvilluara ka pasur një konstatim të qartë se Kushtetuta e Kosovës është shkelur, duke përmendur edhe mosrespektimin e një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese. "Ka pasur diskutime të hapura, shumë përmbytjesore, me një konstatim që Kushtetuta e Kosovës është shkelur. Është

shkelur aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese. Është aktgjykim që sqaron qartë që Kuvendi duhet të konstituohet 30 ditë pas certifikimit të rezultatit zgjedhor. Kjo nuk ka ndodhur", ka deklaruar Hamza pas mbledhjes së grupit parlamentar të kësaj partie.

Ai e ka kritikuar edhe vonesën për thirrjen e seancës, duke thënë se nuk ka pasur arsytim juridik apo faktik përse ajo nuk është thirrur më herët. "Edhe pse Kurti e ka ditur këtë çështje, kanë vazhduar me interpretimet e tyre. Nuk ka asnjë arsytim apo shpjegim faktik, logjik, juridik pse seanca nuk u thirr më herët, por me datën 9", është shprehur ai. Sipas Hamzës, edhe pjesëmarrja në seancën e 9 shtatorit nuk garanton se procesi do të përfundojë me konstituimin e Kuvendit. "Edhe kjo mund të jetë një ftesë që mund të mos konstituohet Kuvendi, pra për të bërë veprime dhe lojëra të tjera politike. PDK-ja do të jetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka thënë

kreu i PDK-së.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Jehona Lushaku-Sadriu, ka thënë se grupi parlamentar i LDK-së do të marrë pjesë në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Pas mbledhjes së grupit parlamentar, Lushaku-Sadriu tha se deputetët e LDK-së kanë vendosur të marrin pjesë në seancë dhe të kontribuojnë në konstituimin e Kuvendit. "Vendosëm si grup që të marrim pjesë në këtë seancë dhe t'i kontribuojmë konstituimit të Kuvendit, megjë Kosova është në një fazë të rëndësishme për themelimin e institucioneve dhe funksionalitetin e tyre", deklaroi ajo. Sipas saj, LDK-ja ka bërë thirrje vazhdimisht që Kuvendi të konstituohet sa më shpejt dhe institucioneve të vendit t'u rikthehet funksionaliteti.

Ndërkaq Aleanca, e cila drejtohet nga Ardian Gjini, nuk do të marrë pjesë në seancën konstituive të thirrur për të mërkurën.

Deputeti i kësaj partie, Ramush Haradinaj, ka thënë se deputetëve u janë djegur mandatet, pasi partia fituese, LV-ja, nuk e ka respektuar afatin kohor për konstituimin e legjislaturës së njëmbëdhjetë. "Kësisoj mandati i 120 deputetëve është djegur", ka thënë Haradinaj për T7.

Më 31 gusht LV-ja dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) arritën marrëveshje për nominimin e Bekim Sejdiut për

president të Kosovës, për zgjedhjen e të cilit kërkohet pjesëmarrja e së paku 80 deputetëve në votim nga 120 sa i ka gjithsej Kuvendi i Kosovës.

Partia fituese e zgjedhjeve, LV-ja, ka 53 deputetë, ndërsa partia e tretë, LDK-ja, 18 deputetë, gjashtë prej të cilëve janë deklaruar kundër marrëveshjes për emrin e Sejdiut.

Ndërkaq, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka 22 deputetë, nuk ka ofruar mbështetje për këtë kandidat, ashtu sikurse Aleanca, e cila ka kushtëzuar votën e tetë deputetëve të saj.

Kreu i LV-së tha më 8 shtator se do të vazhdojnë edhe më tutje takimet dhe bisedimet për ta zgjedhur presidentin e ri të vendit për ta parandaluar shkuarjen në zgjedhje.

"Ne jemi vazhdimisht në komunikim me të tjerët, dhe besoj që duhet t'u shtroni pyetje atyre të cilët po thonë se do ta bojkotojnë zgjedhjen e presidentit", deklaroi Kurti.

Vendi është me ushtruese të detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, që kur Vjosa Osmani i mbaroi mandati në krye të shtetit në prill.

Haxhiu, sipas Kushtetutës, mund ta ushtrojë këtë post vetëm për gjashtë muaj - pra deri më 4 tetor.

Akti më i lartë juridik në vend nuk ka paraparë se çfarë ndodh nëse përfundon kjo periudhë dhe vendi s'ka president të ri.

‘LIRIA KA EMËR’, AKSION PARA EULEX-it PËR ISH-KRERËT E UÇK-së: NË EMËR TË POPULLIT, SHPALLENI TË PAFAJSHËM!

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Aktivistë të platformës qytetare “Liria ka Emër” kanë zhvilluar të martën një aktivitet simbolik para objektit të EULEX-it në Prishtinë, ku ndodhet edhe Zyra e Dhomave të Specializuara, duke përcjellë mesazhin: “Në emër të popullit, shpalleni të pafajshëm!”.

Përmes këtij aktiviteti platforma ka kërkuar drejtësi dhe liri për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, ndërsa ka bërë thirrje që në përfundim të procesit gjyqësor të mos harrohet konteksti historik i luftës çlirimtare të Kosovës dhe sakrificat mbi të cilën është ndërtuar liria e vendit.

Para medieeve foli Flaka Fazlija, vajzë dëshmori, e cila tha se prania e saj në këtë aktivitet nuk ishte vetëm si qytetare e Kosovës, por edhe si një prej fëmijëve që liria i ka kushtuar humbjen e babait. “Babai im e ka dhënë jetën që unë, brezi im dhe krejt ky vend për të jetuar të lirë. Ai nuk ka luftuar për privilegje, nuk ka luftuar për

pushtet, as për hakmarrje. Ka luftuar për liri”, tha Fazlija.

Ajo theksoi se kërkesa e platformës dhe e qytetarëve nuk është për hakmarrje, por për drejtësi. “Ne nuk kërkojmë hakmarrje. Ne kërkojmë drejtësi. Ama drejtësia nuk mundet me qenë e drejtë nëse e harrojmë historinë. Nuk mundet me pasë drejtësi nëse harrohet kush ka qenë agresori dhe kush ka luftuar për të mbijetuar, për me e mbrojt familjen, shtëpinë dhe vendin e vet”, deklaroi ajo.

Duke iu referuar pankartës së vendosur para objektit të EULEX-it, Fazlija tha se mesazhi për pafajësinë përfaqëson bindjen dhe pritjen e mijëra qytetarëve të Kosovës. “Kjo pankartë është një kërkesë. Është një porosi. Është edhe një mesazh shumë i qartë: Kosova nuk ka me heshtë kur dikush tenton me ia shtrembëru historinë dhe me e vendosë luftën e saj çlirimtare në bankën e të akuzuarve”, tha ajo.

Fazlija theksoi se më 16 shtator nuk pritet vetëm një vendim gjyqësor, por një përgjigje që, sipas saj, ka peshë shumë më të gjerë për Kosovën. “Më 16 shtator nuk po presim veç një



aktgjykim. Po presim përgjigje në një pyetje shumë më të madhe: A ka me triumfu drejtësia, apo padrejtësia ka me marrë vullën e drejtësisë?”, deklaroi Fazlija.

Ajo tha se procesi në Hagë nuk prek vetëm katër ish-krerët e UÇK-së, por edhe mënyrën se si

trajtohet historia e një populli që ka kaluar nëpër luftë, përndjekje dhe sakrificë. “Në Hagë nuk janë veç katër emra. Janë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, por bashkë me ta është edhe historia jonë. Është historia e një populli që është përndjekur. Është historia e mijëra familjeve që i kanë humbur më të dashurit e tyre”, tha ajo.

Si vajzë dëshmori, Fazlija tha se familjet që kanë paguar çmimin më të lartë për lirinë nuk mund të heshtin kur vihet në pikëpyetje historia e Kosovës. “Edhe unë jam një prej atyre fëmijëve që liria i ka kushtuar një baba. E për këtë arsye, askush nuk ka të drejtë të na kërkojë sot të heshtim. Kemi paguar tepër shtrenjtë për këtë liri, që sot me heshtë kur vihet në pikëpyetje historia jonë”, theksoi ajo.

Nga objekti i EULEX-it, Fazlija iu drejtua edhe institucioneve ndërkombëtare me kërkesën që të mos harrojnë sakrificën mbi të cilën është ndërtuar

Republika e Kosovës. “Mos harroni mbi çfarë sakrificë është ndërtuar kjo Republikë. Mos e barazoni çlirimtarin me pushtuesin. Mos e ktheni drejtësinë në diçka që e plagos edhe një herë viktimën. Dhe mos prisni që Kosova me heshtë nëse padrejtësia bëhet në emër të drejtësisë”, tha ajo.

Në fund, Fazlija paralajmëroi se zëri i qytetarit në mbështetje të luftës çlirimtare dhe të çlirimtarëve do të vazhdojë të dëgjohet edhe në ditët në vijim. “Ne kemi me fol. Kemi me marshu. Kemi me kujtu. Dhe kemi me e mbrojt të vërtetën tonë historike me krejt vendosmërinë që e kemi. Sepse liria që na e kanë lanë dëshmorët nuk është dhuratë që negociohet. Është amanet. E amaneti nuk harrohet”, përfundoi ajo.

Aktivitetet e platformës qytetare “Liria ka Emër” vazhdojnë në prag të Marshit për Liri që do të mbahet më 12 shtator, nga ora 14:00, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë.



‘LIRIA KA EMËR’ FTON QYTETARËT NË ‘MARSHIN PËR LIRI’ MË 12 SHTATOR

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Ismail Tasholli dhe Eliza Hoxha, edhe një herë u kanë bërë thirrje qytetarëve të marrin pjesë në “Marshin për Liri”, i cili do të mbahet më 12 shtator në Sheshin “Skënderbeu”, në Prishtinë, nga ora 14:00.

Tasholli, në një konferencë për medie, u shpreh se mobilizimi i qytetarit po ndihet kudo nëpër Kosovë dhe në diasporë. “Kjo gatishmëri na bën të besojmë se në ditën e Marshit nuk do të jemi thjesht shumë njerëz në një vend. Do të jemi njerëz të bashkuar nga kujtesa, solidariteti dhe kërkesa për drejtësi. Prandaj, sot ftesa jonë



shkon për secilin, ejani dhe bëhuni pjesë e Marshit. Ejani me familjet tuaja, me miqtë

dhe me bashkëqytetarët tuaj. Le të jetë pjesëmarrja jonë masive, paqësore dhe

dinjitoze”, bëri thirrje Tasholli. Ai tha se lansimi i orëve të pritjes brenda dhe jashtë Kosovës dhe ndezja e zjarreve nëpër zona janë shndërruar në vende takimi e bashkimi të qytetarëve, pa dallim. “Kemi parë njerëz që kanë ardhur jo sepse dikush ua ka kërkuar, por sepse e kanë ndier se duhet të jenë aty. Kemi parë qytetarë të moshave të ndryshme, familje, të rinj e të reja dhe bashkatdhetarë tanë që kanë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e kësaj thirrjeje. Zjarret e ndezura nëpër zona e kanë bartur të njëjtin mesazh nga njëri cep i vendit në tjetrin, kujtesa jonë është e gjallë dhe solidariteti ynë nuk është

shuar. Ndërsa aksioni i sotëm para EULEX-it ishte vazhdimësi e kërkesës sonë për drejtësi”, theksoi Ismail Tasholli.

Ndërkaq Eliza Hoxha njoftoi se do të ketë transport të organizuar nga e gjithë Kosova, në mënyrë që largësia të mos jetë pengesë për askënd që do të marrë pjesë në marsh. “Nga qytetet dhe komunat anembanë vendit do të organizohen nisje drejt marshit. Pikat e nisjes, oraret dhe detajet e transportit do të bëhen publike me kohë përmes njoftimeve tona zyrtare. Mesazhi ynë është i thjeshtë, kudo që jeni, bëhuni gati”, tha ajo.

THELLOHEN PËRÇARJET NË LDK, PËRPLASEN ABDIXHIKÛ, HOTI DHE BAJRAMI

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, u është përgjigjur deklaratave të Avdullah Hotit dhe Hykmete Bajramit, të cilët, në dy intervista televizive, folën për nevojën e ndryshimit të leadershipit në LDK. Hykmete Bajrami shprehu ambicien e saj për të kandiduar për kryetare të LDK-së në zgjedhjet e brendshme të vitit të ardhshëm, ndërsa Avdullah Hoti tha se Kujtim Shala duhet të jetë kryetar i partisë dhe se kandidatë për kryeministre në zgjedhjet e ardhshme parlamentare duhet të jetë Hykmete Bajrami. Abdixhiku, përmes një postimi në “Facebook”, ka reaguar ndaj këtyre deklaratave, duke thënë se “nuk rrotullohet shteti për një ambicie”. “Mendoja se e kanë për parime e për Kosovë; por beteja qenka për kryetar të LDK-së për njëri-tjetrin. Për keqardhje! LDK njihet ndryshe. Me klasë politike që dikur jepte gjithçka për shtetin, jo me të atillë që do ta japë shtetin për vete. Zot, fali, kaq dinë; se populli s’ka për t’i falur!”, ka shkruar Abdixhiku. Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, i është kundërpërgjigjur kreut të partisë, Lumir Abdixhiku, duke e quajtur atë humbës të trefishtë të zgjedhjeve dhe i

cili e ka degraduar dhe përçarë partinë. Ajo i është përgjigjur Abdixhikut duke i thënë se është njeriu i fundit që mund të flasë për parime, ambicie, shtet e pushtet. Deputetja Bajrami ia ka numëruar Abdixhikut humbjet e zgjedhjeve dhe ia ka rikujtuar zotimet e tij për largim nga kreu i partisë. Edhe Avdullah Hoti ka reaguar sërish të martën për zhvillimet në LDK. Ai ka kërkuar mbajtjen e një konvente të madhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës, me synimin për ta rikthyer unitetin dhe besimin brenda partisë. Hoti ka thënë se LDK-ja ka nevojë urgjente për një “Konventë të madhe” dhe një “Pajtim të madh”, përmes të cilit, sipas tij, do të qartësohej rruga e partisë përpara. Ai ka propozuar që në këtë konventë të përfshihen të gjitha strukturat e LDK-së, përfshirë anëtarët e Kuvendit Qendror, Këshillin e Përgjithshëm, grupin parlamentar, kryetarët dhe kryesitë e degëve, anëtarët e LDK-së në kuvendet komunale si dhe Forumet e Gruas dhe Rinisë. Sipas Hotit, konventa duhet të shërbejë si një moment i ri për LDK-në dhe ta përcaktojë ekipin që do ta udhëheqë partinë drejt zgjedhjeve të ardhshme. “Mbi të gjitha, Konventa duhet ta rivendosë besimin e brendshëm, që është parakusht për unitet, punë ekipore dhe fitore”, ka shkruar



Hoti në “Facebook”. Ai ka deklaruar se angazhohet për një “Konventë të pajtimit të madh”, duke theksuar se vetëm një LDK e bashkuar mund ta fitojë besimin e qytetarëve. Vendimi i gjashtë deputetëve të LDK-së për të mos e mbështetur marrëveshjen e partisë së tyre me Lëvizjen Vetëvendosje për zgjedhjen e Bekim Sejdiut president, ka nxjerrë në sipërfaqe ndarjet brenda LDK-së, ka shtuar mundësinë që Kosova të përfundojë sërish në zgjedhje dhe ka ngritur një pyetje më të madhe për vetë partinë: sa e bashkuar mund të dalë prej kësaj krize? Kryetari i LDK-së, Lumir

Abdixhiku, e cilësoi vendimin e 6 deputetëve të partisë së tij si një dëm “të pariparueshëm ndaj gjithë procesit” dhe paralajmëroi se ai mund ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Abdixhiku ka shkruar edhe më tej në kritikën ndaj gjashtë deputetëve. Ai tha se ata që nuk respektuan vendimin e Kryesisë së LDK-së, “nëse asgjë tjetër, do të duhej ta dorëzonin mandatin e deputetit”, ndonëse shtoi se nuk ua ka kërkuar një gjë të tillë. Për zgjedhjen e presidentit kërkohet pjesëmarrja e së paku 80 prej 120 deputetëve të Kuvendit të Kosovës në votim. Në dy raundet e para

nevojiten 80 vota, ndërsa në të tretin 61, me së paku 80 deputetë të pranishëm në sallë. Nëse presidenti nuk zgjidhet as në raundin e tretë, Kuvendi shpërndahet dhe zgjedhjet e reja duhet të mbahen brenda 45 ditësh. LV-ja ka 53 mandate, ndërsa LDK-ja 18. Por, pas kundërshtimit të gjashtë deputetëve, sipas Abdixhikut, vetëm 12 deputetë të LDK-së janë të gatshëm ta mbështesin Sejdiun. Edhe nëse kësaj llogarie i shtohen deputetët e komuniteteve joserbe që kanë bashkëpunuar me LV-në, numri mbetet nën pragun e nevojshëm.

IKD-JA: BLOKADA INSTITUCIONALE RREZIKON MBI 43.8 MILIONË EURO NGA FUSHA 5 E PLANIT TË RRITJES PËR SUNDIMIN E LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka theksuar përmes një komunikate se deri në fund të vitit 2026, Kosova duhet të përmbushë tetë hapa në Fushën 5 të Planit të Rritjes, me vlerë rreth 43.8 milionë euro. Sipas IKD-së, këto mjete lidhen drejtpërdrejt me reforma në gjyqësor, luftën kundër korrupsionit, të drejtat themelore, demokracinë dhe politikën e vizave. “Kjo fushë përfshinë disa prej reformave më të rëndësishme për funksionimin demokratik të shtetit: përmirësimin e performancës dhe llogaridhënies së gjyqësorit,



miratimin e Kodit Civil, forcimin e luftës kundër korrupsionit, avancimin e të

drejtave themelore, funksionalizimin e Kuvendit dhe politikën e vizave. Këto nuk

janë vetëm reforma teknike. Një pjesë e tyre kërkon vendimmarrje nga Kuvendi, ndërsa të tjerat kërkojnë institucione funksionale dhe veprim të koordinuar nga Qeveria”, është thënë në komunikatën e IKD-së. Instituti i Kosovës për Drejtësi ka shtuar se Kosova ka mbetur pa një strategji shtetërore kundër korrupsionit që nga 2017, fakt të cilin Komisioni Evropian ne vazhdimësi e ka evidentuar mungesën e kornizës së nevojshme strategjike në luftën kundër korrupsionit. “Ngjashëm, Kodi Civil ka mbetur peng i mungesës së koordinimit

politik, përfshi edhe brenda shumicës qeverisëse. Ndonëse kanë kaluar më së një muaj nga afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit, i njëjti mbetet jofunksional, ndërsa formimi dhe funksionalizimi i institucioneve pas zgjedhjeve të 7 qershorit 2026 është vënë në pikëpyetje. Vazhdimi i kësaj bllokade rrezikon përmbushjen e obligimeve të Kosovës dhe disbursimin e mbi 43.8 milionë eurove nga kjo fushë. Njëkohësisht, dëmton besueshmërinë e vendit në procesin e reformave dhe të integritimit evropian”, është theksuar në komunikatën e IKD-së.

Faton Peci zgjidhet kryetar i Partisë Guxo

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Faton Peci është zgjedhur kryetar i Partisë Guxo. Lajmin e ka

bërë me dije Donika Gërvalla në rrjete sociale, e cila e ka uruar Pecin për

detyrën e re. “Faton Peci, Kryetar i Partisë Guxo. E ardhmja iu takon atyre që

guxojnë! Urime të gjithëve e na priftë e mbara!”, ka shkruar Gërvalla.



Xhelal Svec̑la dënohet me një vit burgim me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Svec̑la, u dënua të martën me një vit me burgim me kusht, në periudhë verifikuese për një vit, për veprën penale “përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”.
Më 2 shtator Svec̑la i Lëvizjes Vetëvendosje (LV) u shpall fajtor për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës më 21 mars të vitit 2018, në ditën kur ishte ratifikuar marrëveshja e demarkimit të kufirit me Malin e Zi.
Më 10 prill para Gjykatës

Themelore në Prishtinë, Svec̑la ishte deklaruar i pafajshëm përballë akuzave. Ndërkaq, në seancën e 2 shtatorit ai nuk ishte i pranishëm në gjykatore. Paraprakisht, në seancën për matjen dhe caktimin e dënimit, prokurori Valdrin Krasniqi propozoi dënim me dy vjet burgim dhe 3 mijë euro gjobë, raporton “Betimi për Drejtësi”. Sipas aktakuzës së ndryshuar, Svec̑la akuzohet se më 21 mars, në sallën plenare të Kuvendit, gjatë një seance të jashtëzakonshme ka përdorur gaz lotsjellës. Sipas Prokurorisë, ai e ka aktivizuar bombolën me gaz dhe e ka hedhur brenda

sallës disa herë pa paralajmërim, duke mos u dhënë personave të pranishëm mundësi për t’u larguar. Rreth akuzave për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës në gusht të 2016 është liruar së voni ministri në detyrë i Punëve të Jashtme i Kosovës, Glauk Konjufca.
Gazi lotsjellës është përdorur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për të kundërshtuar një sërë zhvillimesh politike. Më 2015 deputetët e LV-së, që kundërshtonin marrëveshjen për normalizimin e raporteve me Serbinë, hodhën gaz lotsjellës në sallën plenare.



Më pas, edhe ata të Aleancës dhe të Nismës Socialdemokrate iu bashkuan kundërshtimit për

marrëveshjen për demarkimin e kufirit me Malin e Zi, duke hedhur gaz në ambientet e Kuvendit.

TRAJTIMI I MLLADIQIT NË SERBI: IRONI E MADHE, PO, ÇUDI JO!



Shkruan: Valon MURATI

Ka një reagim kundër pushtetit në Serbi nga vendet evropiane, përfshirë Bashkimin Evropian, për varrimin me nderime shtetërore dhe ushtarake të Ratko Mlladiqit, të dënuar ndër të tjera për gjenocid në Srebrenicë në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi. Ajo që duket qartazi është habia e evropianëve dhe

figurave të ndryshme intelektuale dhe politike perëndimore ndaj kësaj qasjeje të Beogradit zyrtar, duke e konsideruar si madhërim të një kriminelit të luftës dhe përpjekje për ndryshimin e historisë.
Natyrisht kjo ka një histori, që ka shtruar rrugën për këtë trajtim të kriminelëve të luftës

në Serbi dhe në përgjithësi për rolin e Serbisë në luftërat në ish-Jugosllavi. Ndonëse më së shumti serbë janë paditur dhe gjykuar nga ky tribunal, dhe ndonëse Serbia u bombardua nga NATO-ja në pranverën e vitit 1999 për masakrat që i bënte në Kosovë, asnjë regjim në Beograd, edhe pas ndryshmeve të vitit 2000, nuk e

trajtoi regjimin e Millosheviqit si përgjegjës në kryesor të luftërave dhe vuajtjeve sidomos të boshnjakëve, shqiptarëve, kroatëve por edhe të vetë serbëve në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë.
Tribunali i Hagës, i krijuar në vitin 1993, ishte tribunali i parë ndërkombëtar pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Në Nuremberg, udhëheqja naziste jo vetëm që u dënua individualisht, por edhe një sërë organizatash si Partia Nacional Socialiste, Gestapoja, Trupat SS etj u shpallën organizata kriminale dhe iu ndalua aktiviteti. Në Gjermani e Austri më pas ndodhën, për aq sa ndodhën procesi i denaziifikimit (nevojat e Luftës së Ftohtë krijuan rrethanat të ky proces të zbutej). Edhe në Japoni u dënuan udhëheqësit japonez të luftës në Tribunalin e Tokios. Në asnjë rast nuk kishte dënim për aleatët, përkundër faktit se edhe ata kishin qenë të përfshirë në një sërë vrasjesh, bombardimesh të civilëve e deri tek hedhja e bombave atomike në Hiroshimë dhe Ngasaki.
Natyrisht fituesit, që ishin edhe në anën e drejtë të historisë, i bën gjyqin edhe penal, edhe politik e edhe historik, humbësve, që kishin shkaktuar Luftën e Dytë Botërore me politikat e tyre jo vetëm ekspansioniste por edhe jo njerëzore.
Zhvillimi i të drejtës penale ndërkombëtare në kontekstin e pas Luftës së Dytë Botërore shkoi drejt fuqizimit të konceptit të përgjegjësisë individuale në zinxhirin komandues ushtarak dhe

politik. Por në rastin e Tribunalit për ish Jugosllavi në Hagë, u shkua larg dhe u dërgua mesazhi politik (që po ashtu ishte natyrisht një kompromis politik në kuadër të OKB-së edhe me Rusinë) se ndonëse Serbia mund të jetë më shumë fajtores, të gjithë janë fajtorë për luftërat në ish-Jugosllavi. Kështu rezultati, pajtimi ndëretnik dhe dënimi i krimeve të luftës dhe një lloj pranimi i fajeve, nuk arriti rezultatin e duhur. Në njërin anë ky mesazh krijoi pakënaqësi tek kroatët, boshnjakët e shqiptarët, e në anën tjetër u shfrytëzua maksimalisht politikisht nga politika serbe për të rehabilituar jo vetëm kriminelë të caktuar të luftës, por për të relativizuar edhe vetë rolin e Serbisë në këtë proces.
Kulmi i relativizmit të peshës së krimeve të luftës në mes të agresorit dhe atyre që luftuan për çlirim, liri dhe mbrojtjen vendin e tyre, ishte presioni ndërkombëtar, prapë në një kontekst të caktuar politik të raporteve me Rusinë, që Kosova të krijoi Dhomat e Specializuara për trajtimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Kosovë. Një gjykatë që ndjek vetëm një etni, vetëm shqiptarët dhe vetëm pjesëtarët e UÇK-së në një vend ku ata ishin viktimat dhe luftuan për liri e u përballën me një makineri të sofistikuar vrasëse shtetërore. Një gjykatë e themeluar për të ndjekur shqiptarët për krime të luftës, në kohën kur të gjithë e dimë se drejtësia në Kosovë, për krimet e kryera nga pushtuesi serb, as për afërsisht nuk është konsumuar.

Përparim Rama pret shefin e ri të EULEX-it, diskutojnë për sigurinë në Prishtinë

Prishtinë, 8 shtator - Kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, ka pritur në takim shefin e ri të Misionit të EULEX-it në Kosovë, Antero Lopes, të cilin e

ka uruar për detyrën e re dhe i ka dëshiruar shumë sukses në misionin e tij.
Gjatë takimit është diskutuar për rëndësinë e bashkëpunimit

institucional, sfidat në fushën e sigurisë dhe angazhimin e përbashkët për një Prishtinë më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Rama ka theksuar se kryeqyteti do të vazhdojë të jetë partner i hapur dhe konstruktiv në forcimin e sigurisë dhe sundimit të ligjit.



BQK-ja DHE SEKTORI BANKAR VAZHDOJNË PËRGATITJET PËR INTEGRIMIN NË SEPA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Në vazhden e përgatitjeve për integrimin e Republikës së Kosovës në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi punëtorinë “SEPA Implementation: Processes, Requirements and Next Steps”, me pjesëmarrjen e stafit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), drejtuesve dhe përfaqësuesve të sektorit bankar si dhe ekspertëve të fushë. Punëtorja shërbeu si vazhdimësi e diskutimeve dhe përgatitjeve të përbashkëta të BQK-së dhe sektorit bankar, duke u fokusuar në kërkesat për aderim në skemat SEPA, përgatitjet teknike dhe operative, si dhe në hapat që duhet të ndërmarrin bankat për ta siguruar gatishmërinë e tyre me kohë.

Në fjalën e tij, guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, theksoi se integrimi në SEPA përbën një nga prioritetet strategjike të BQK-së dhe një nga proceset më të rëndësishme për integrimin financiar të Kosovës me Bashkimin Evropian. Ai vlerësoi se ky proces, së bashku me projektin TIPS Clone për pagesat e shpejta, përfaqëson një transformim të rëndësishëm të infrastrukturës

së pagesave, me përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët, bizneset dhe ekonominë e vendit.

Ai ka theksuar se BQK-ja ka avancuar në vazhdimësi përgatitjet institucionale për SEPA përmes përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ me kërkesat evropiane, përgatitjes së kornizës së aplikimit dhe koordinimit me institucionet vendore, sektorin financiar dhe partnerët ndërkombëtarë. “Paralelisht me përmbylljen e hapave të mbetur institucionale, përkatësisht miratimin nga Kuvendi të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, fokusi po orientohet gjithnjë e më shumë drejt gatishmërisë së sektorit bankar për fazën e aderimit dhe zbatimit”, ka thënë ai.

Guvernatori Ismaili ka pohuar se pranimi i Kosovës në SEPA duhet ta gjejë sektorin bankar të përgatitur për aderim dhe pjesëmarrje operative në skemat përkatëse, marrë parasysh kompleksitetin dhe kohën e nevojshme të procesit nga përvojat e rajonit. Për këtë arsye, ai ka thënë se përgatitjet teknike dhe operative duhet të vazhdojnë edhe më tej, në vazhden e udhëzimeve dhe



aktiviteteve të ndërmarra deri më tani.

BQK-ja pret që secila bankë dhe institucion i pagesave, krahas trajtimit të SEPA-s si projekt strategjik institucional dhe nën vëmendjen e vazhdueshme të menaxhmentit të lartë, të alokojë resurse të dedikuara, me përgjegjësi të qarta dhe plane konkrete për zbatimin në praktikë.

Gjatë kësaj punëtorie u tha se, krahas koordinimit në nivel sektorial, secila bankë duhet t'i finalizojë përgatitjet individuale për përshtatjen e sistemeve dhe

procedurave, sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat e skemave SEPA, realizimin e testimeve dhe garantimin e gatishmërisë operative.

Gjithashtu u diskutuan kërkesat dhe proceset e aderimit në SEPA si dhe përvojat praktike që mund t'i ndihmojnë bankat në përgatitjen e tyre.

Në këtë kuadër u vlerësua rëndësia e shfrytëzimit të përvojës së bankave dhe grupeve bankare që tashmë operojnë në vendet e SEPA-s, me qëllim të transferimit të njohurive dhe përshtetimit të procesit të

përgatitjeve.

Po ashtu, u tha se BQK-ja do ta vazhdojë me prioritet të lartë koordinimin dhe diskutimet me sektorin bankar dhe të pagesave, duke përcjellë nga afër avancimin e përgatitjeve dhe duke adresuar së bashku çështjet që kërkojnë koordinim të mëtejshëm. “Synimi është që përgatitjet institucionale dhe ato të sektorit të avancojnë paralelisht, në mënyrë që Kosova dhe sistemi i saj financiar të jenë të gatshëm për një integrim sa më të shpejtë, efektiv dhe funksional në SEPA”, ka thënë guvernatori Ismaili.

ZKA-ja MBAJTI TRYEZË PËR AUDITIVE

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka organizuar tryezën e diskutimit “Propozimplan për auditimet e performancës dhe të pajtueshmërisë” për sezonin auditues 2026/2027.

Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe shoqatave profesionale kontribuan duke propozuar tema për auditime të performancës dhe të pajtueshmërisë në fusha me interes publik dhe çështje me rëndësi që mund të përfshihen në Planin Vjetor të Auditimit.

Punimet e tryezës i hapi zëvendësauditori i përgjithshëm Bezat Halilaj, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me palët e interesit përmes të cilit synohet të sigurohet se auditimet e ZKA-së adresojnë çështjet që



kanë rëndësi për qytetarët dhe për menaxhimin e parasë publike.

ZKA ka për qëllim që në sezonin 2026/2027 të ketë një plan me

tema prioritare, të auditueshme dhe me potencial të qartë për ndikim. “Për këtë arsye kemi vendosur që në procesin e

konsultimit me shoqërinë civile dhe shoqatat profesionale të përfshijmë edhe diskutimin e temave për auditimet e pajtueshmërisë. Në përzgjedhjen e temave për sezonin 2026–2027, duhet të fokusohemi në shkaqet që qëndrojnë pas tyre, duke analizuar sistemet, proceset dhe faktorët institucionale që ndikojnë në krijimin dhe përsëritjen e dobësive, prandaj në këtë drejtim kontributi i shoqërisë civile është i rëndësishëm”, deklaroi z. Halilaj.

Temat preliminare të auditimit të performancës dhe të pajtueshmërisë për sezonin 2026/2027 të cilat mbulojnë fusha dhe çështje me interes për qytetarët u paraqitën nga ndihmësauditorja e përgjithshme Myrvete Gashi Morina dhe

ndihmësauditori i përgjithshëm Zuke Zuka.

Përfaqësuesit e OShC-së shprehën propozimet dhe rekomandimet e tyre për fusha që prekin interesin publik, duke ofruar sugjerime të vlefshme për përfshirje në planifikimin e ZKA-së për sezonin e ardhshëm. Ata u fokusuan tek auditimet që trajtojnë prokurimin, zhvillimin e qëndrueshëm, subvencionet në bujqësi, operimin e institucioneve publike në objekte me qira, kontraktimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale në komuna, funksionimin e pozitive me ushtrues detyre, planin e rritjes dhe zbatimin e reformave, subvencionimin e librave, memorandumet e bashkëfinancimit, hartat zonale në komuna etj.

Kurti vizitoi shtëpinë përfituese të masës për eficiencë të energjisë

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka vizituar një nga 51 shtëpitë e rinovuara përmes masës me eficiencë të energjisë. Kryeministri Kurti gjatë vizitës në familjen Dragidela tha se deri në fund të vitit do t'i përkrahin 192 familje duke ua rinovuar shtëpitë, e më 2028 ky numër do të shkojë në 280 familje në tërë Kosovën. “Kjo familje ka konsumuar mbi

85 megavat orë në vit dhe tash do të ketë një rënie të konsumit plus kushte më të mira brenda, që do të thotë e ngrohtë gjatë dimrit dhe e freskët gjatë verës, me një zbritje të shpenzimit të energjisë rreth 74 për qind”, tha kryeministri.

Sipas kryeministrit Kurti, pesë anëtarët e familjes Dragidela do të kenë kushte më të dinjitetshme për jetë pas

investimeve që janë bërë në termoizolimimin e fasadës dhe të çatisë.

Ai ka falënderuar Qeverinë e Danimarkës për financimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, UNDP-në për partneritetin e shkëlqyeshëm, Ministrinë e Ekonomisë dhe Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë për punën dhe angazhimin për realizimin e këtij projekti.



AFD-ja 'THYEN' BARRIERAT, KUSH PO E VOTON TË DJATHTËN EKSTREME?



Vala e AfD-së, partisë së ekstremit të djathtë në Gjermani, ka përfshirë pothuajse të gjithë landin e Saksoni-Anhaltit. Pesë vjet më parë, pjesa më e madhe e zonave zgjedhore në këtë land votoi për CDU-në, partinë e qendrës së djathtë të kancelarit Friedrich Merz.

Këtë herë rezultati ka ndryshuar ndjeshëm.

Në zgjedhjet e vitit 2021, AfD-ja doli e para vetëm në një zonë zgjedhore, ndërsa CDU-ja fitoi në 40 zona të tjera. Tani situata është përmbytur: AfD-ja ka dalë e para në 38 zona, ndërsa në tri zonat e mbetura, që ndodhen në qytetet më të mëdha, Magdeburg dhe Halle, ka fituar partia e majtë Die Linke.

Të dhënat për lëvizjen e votuesve tregojnë se si arriti AfD-ja në këtë rezultat. Partia ka bindur të votojnë 157 mijë persona që pesë vjet më parë nuk kishin marrë pjesë në zgjedhje.

Por pjesa më e madhe e votave të reja ka ardhur nga CDU-ja. Rreth 83 mijë votues të CDU-së

kanë kaluar te AfD-ja.

AFD-ja ka marrë gjithashtu rreth 20 mijë vota nga partitë e majta dhe pothuajse po aq nga FDP-ja, partia liberale, e cila këtë herë nuk arriti të kalojë pragun prej 5% për të hyrë në parlamentin e landit.

Vetëm rreth 2 mijë votues janë larguar nga AfD-ja drejt partisë BSW të Sahra Wagenknecht.

Burrrat votojnë më shumë për AfD-në

Dallimi mes burrave dhe grave është i dukshëm. Rreth gjysma e burrave në Saksoni-Anhalt kanë votuar për AfD-në. Te gratë, mbështetja për këtë parti është 39%.

Në të kundërt, gratë kanë votuar më shumë për CDU-në: 19% e grave, krahasuar me 15% të burrave.

AFD-ja është shumë e fortë edhe te të rinjtë

Të dhënat sipas moshës janë veçanërisht interesante.

Mes të rinjve nën 25 vjeç, AfD-ja ka marrë 42% të votave. CDU-ja, e cila ka drejtuar Saksoni-Anhaltin që prej vitit 2002, ka marrë vetëm 5% në këtë grupmoshë.

Partia e majtë Die Linke ka marrë 17% të votave të të rinjve nën 25 vjeç.

Megjithatë, mbështetjen më të madhe AfD-ja e ka te personat e moshës së mesme. Mes votuesve 35 deri në 59 vjeç, ajo ka marrë më shumë se 52% të votave.

Rezultati më i dobët i AfD-së është te personat mbi 70 vjeç, ku ajo është barazuar me CDU-në, me nga 31%.

Ndërkohë, Të Gjelbrit kanë marrë mbështetjen më të madhe te të rinjtë e moshës 25-34 vjeç, me 16%.

Më pak arsim, më shumë vota për AfD-në

Një tjetër faktor i rëndësishëm është niveli i arsimimit.

Mes personave me arsim të mesëm ose profesional, AfD-ja ka marrë pothuajse 60% të

votave. Në këtë grup, Të Gjelbrit kanë marrë vetëm 3-5%.

Ndërsa te personat që kanë përfunduar universitetin, mbështetja për AfD-në bie në 30%. Në këtë grup, Të Gjelbrit marrin 16%, pothuajse dyfishin e rezulttit të tyre në total.

Për CDU-në, niveli i arsimimit duket se ka shumë pak ndikim: partia ka marrë rezultate të ngjashme si te personat me arsim më të ulët, ashtu edhe te ata me arsim të lartë.

Pakënaqësia ekonomike favorizon AfD-në

Edhe gjendja ekonomike duket se ka ndikuar shumë në mënyrën se si kanë votuar njerëzit.

Mes punëtorëve, AfD-ja ka marrë gati 60% të votave.

Ndërsa te personat që thonë se janë të pakënaqur me gjendjen e tyre financiare, AfD-ja ka marrë pothuajse dy të tretat e votave. Asnjë parti

tjetër nuk ka arritur 10% në këtë grup.

Veçanërisht i dobët është rezultati i SPD-së, partisë kryesore të së majtës gjermane. Mes njerëzve që ndihen ekonomikisht më të pasigurt, SPD-ja ka marrë vetëm 3% të votave.

Në anën tjetër, te personat që janë të kënaqur me të ardhurat dhe gjendjen e tyre ekonomike, mbështetja për AfD-në bie në 37%. CDU-ja arrin në 20%, ndërsa edhe SPD-ja dhe Të Gjelbrit marrin rezultate më të mira.

Filozofi gjerman Hegel shkruante se "bufi i Minervës e nis fluturimin vetëm në muzg", duke dashur të thoshte se shpesh kuptimi i ngjarjeve bëhet i qartë vetëm pasi ato kanë ndodhur. Në rastin e Saksoni-Anhaltit, megjithatë, rezultati i zgjedhjeve mund të jetë fillimi i një epoke të re, jo vetëm për politikën gjermane, por edhe për politikën europiane.

INVESTIGIMI TRONDITËS: NETANYAHU E DINTE DHE SHPËRFILLI PARALAJMËRIMET PËR SULMIN E 7 TETORIT



Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ishte paralajmëruar rreth një javë e gjysmë para sulmit të 7 tetorit 2023 se Hamasi po përgatiste një operacion të madh kundër Izraelit, pretendon një investigim i gazetës Haaretz.

Sipas raportimit, paralajmërimi iu dha drejtpërdrejt Netanyahu nga presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Mohamed bin Zayed, gjatë një telefonate rreth 45-minutëshe në fund të shtatorit 2023.

Lideri i Emirateve të Bashkuara Arabe i shprehu shqetësimin e tij për planet e Yahya Sinwarit dhe paralajmëroi se një sulm i madh mund të shkaktonte gjakderdhje dhe destabilizim në të gjithë rajonin.

Investigimi, i bazuar në dhjetëra burime në Izrael dhe jashtë tij, dokumente të brendshme, korrespondencë dhe regjistrime, pretendon se Netanyahu e mori

paralajmërimin me qetësi.

Sipas burimeve të cituara, ai i tha bin Zayed se besonte se Hamasi mund të tentonte një operacion në Bregun Perëndimor dhe se Izraeli ishte i përgatitur për çdo skenar.

Haaretz pretendon se paralajmërimi nuk iu përcoll më pas drejtuesve kryesorë të aparatit të sigurisë izraelite, përfshirë kreun e shërbimit të inteligjencës dhe sigurisë së brendshme të Izraelit (Shin Bet-it), drejtorin e Mossadit dhe shefin e Shtabit të Ushtrisë.

Megjithatë, sinjale të tjera për një përshtallëzim të mundshëm kishin mbërritur te autoritetet izraelite.

Në shtator, Yahya Sinwar i kishte thënë një ndërmjetësi palestinez se po përgatiste një “surprizë të madhe” dhe kishte përdorur fjalën “zilzal”, që në arabisht do të thotë “tërmet”.

Ky informacion iu përcoll Shin

Bet-it më 15 shtator. Dy ditë më vonë u zhvillua një takim i sigurisë ku morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes, Yoav Gallant, dhe përfaqësues të inteligjencës ushtarake.

Kreu i Shin Bet-it, Ronen Bar, paralajmëroi për mundësinë e një përshtallëzimi dhe kërkoi masa më të forta mbrojtëse në Gaza dhe Bregun Perëndimor. Sipas investigimit, edhe kreu i inteligjencës egjiptiane, Abbas Kamel, kontaktoi Netanyahu në ditët para sulmit dhe e paralajmëroi për një operacion “të pazakontë” dhe potencialisht të rrezikshëm që Hamasi mund të ishte duke përgatitur.

Në të njëjtën kohë, Izraeli dhe Hamasi kishin zhvilluar kontakte sekrete për një marrëveshje që synonte uljen e tensioneve në Gaza.

Negociatat përfshinin lehtësimin e bllokadës, rritjen e furnizimeve dhe krijimin e mundësive ekonomike për palestinezët, ndërsa në tryezë

ishte edhe një marrëveshje për shkëmbimin e të burgosurve. Sipas Haaretz, deri në fund të gushtit 2023 Netanyahu kishte miratuar në parim lirin e 30 të burgosurve palestinezë, përfshirë 20 të dënuar me burgim të përjetshëm, në këmbim të katër izraelitëve të mbajtur në Gaza. Megjithatë, mbledhja e komitetit ministror që duhej të miratonte marrëveshjen u shty vazhdimisht dhe negociatat përfundimisht ngecën.

Më 7 tetor 2023, Hamasi nisi sulmin e befasishëm ndaj Izraelit, duke shkaktuar një prej krizave më të rënda të sigurisë në historinë e vendit dhe duke çuar në marrjen peng të qindra personave. Investigimi ngre gjithashtu pikëpyetje mbi mënyrën se si u trajtuan ofertat për lirin e pengjeve në ditët e para të luftës.

Sipas burimeve të cituara, pati kontakte për lirin e disa

civilëve, ndërsa Katari ofroi ndërmjetësimin mes palëve.


Megjithatë, në ditët e para pas sulmit, autoritetet izraelite ishin të përqendruara te kundërpërgjigjja ushtarake dhe lufta ndaj Hamasit.

Zyra e Netanyahu e ka mohuar kategorikisht investigimin e Haaretz, duke e cilësuar atë si “një gënjeshtër absolute”.

Sipas saj, Netanyahu nuk ka zhvilluar bisedë me presidentin e Emirateve gjatë periudhës në fjalë dhe nuk ka marrë asnjë paralajmërim prej tij.

Edhe ish-kreu i Shin Bet-it, Ronen Bar, dhe ish-shefi i Shtabit të Ushtrisë izraelite, Herzl Halevi, kanë deklaruar se nuk ishin informuar për paralajmërimin që, sipas Haaretz, kishte ardhur nga presidenti i Emirateve.

Gazeta thotë se ka kontaktuar me presidentin e Emirateve për një reagim, por nuk ka marrë përgjigje.



Ballkani përforcon mbrojtjen me Lendrit Shalën

SUHAREKË, 8 SHTATOR - Ballkani ka bërë përforcimin e radhës në afatin kalimtar, duke afruar mbrojtësin 22-vjeçar, Lendrit Shalën. Shala është formuar në

futbollin zviceran dhe është pjesë e Përfaqësueses së Kosovës U21. "FC Ballkani ka përforcuar repartin e mbrojtjes me Lendrit Shalën. Shala, 22

vjeç, është një mbrojtës i formuar në futbollin zviceran dhe pjesë e përfaqësueses së Kosovës U21. Me karakteristikat e tij fizike dhe eksperiencën e

fituar në karrierën e deritanishme, ai vjen për të sjellë më shumë siguri dhe konkurrencë në mbrojtjen e skuadrës", ka njoftuar Ballkani.



KURTI PRET NË TAKIM MEDALISTËT E XHUDOS: NA TREGUAN ÇFARË MUND TË ARRIJË KOSOVA



PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim ekipin e xhudistëve që kanë fituar medalje në Lojërat Mesdhetare Taranto 2026. "Diskutuam rezultatet dhe analizat e para nga Lojërat Mesdhetare, çfarë duhet të mësojmë prej tyre dhe hapat

që duhet t'i ndërmarrim në katër vitet që na ndajnë nga Prishtina 2030", ka thënë Kurti. Ai ka vlerësuar se "xhudoja na ka treguar se çfarë mund të arrijë Kosova kur talenti shoqërohet me punë afatgjatë, profesionalizëm dhe standarde të larta". "Urime edhe një herë sportistëve,

kryemjeshtrit Driton Kuka, trajnerëve Majlinda Kelmendi e Fatos Tabaku dhe gjithë ekipit të xhudos", ka thënë kryeministri Kurti. Nga Taranto, Laura Fazliu është kthyer me medalje të argjendtë, ndërsa Akil Gjakova, Flaka Loxha, Fatjona Kasapi dhe Shpati Zekaj kanë fituar medalje të bronzta.

TRAJNERJA SHQIPTARE, ELENA SADIKU NOMINOHEP PËR "TOPIN E ARTË"

PARIS, 8 SHTATOR - Trajnerja nga Kosova, Elena Sadiku, është nominuar për "Topin e Artë", përkatësisht në garën për trajneren më të mirë të vitit në konkurrencën e femrave. Sadiku e ka drejtuar Celticun në Skoci, ndërsa tani është në krye të

Hackenit në Suedi. Ajo është në garë për "Topin e Artë" me Jonatan Giraldezin e Lyonit, Andree Jeglertzin e Manchester Cityt, Nils Nielsenin e Japonisë dhe Pere Romeun e Barcelonës. Edhe pse bëhet fjalë për futbollin e femrave, Sadiku është e vetmja

trajnerë e nominuar. Sadiku është 32-vjeçare dhe një prej trajnerëve më të vlerësuar në futbollin evropian. Me Hackenin, Sadiku ka fituar garën "Europa Cup", ndërsa me Celticun kishte fituar Premierë Ligën skoceze dhe kishte shkruar histori.



LIVERPOOLI ARRIN MARRËVESHJE REKORD PËR SPONSORIZIMIN E FANELLËS, MË E MADHJA NË HISTORINË E LIGËS PREMIERE

LONDËR, 8 SHTATOR - Liverpooli ka njoftuar një marrëveshje rekord për sponsorizimin e fanellës me "Turkish Airlines", e cila pritet të jetë më e vlefshmeja në historinë e Ligës Premiere. Liverpooli ka konfirmuar se "Turkish Airlines" do ta zëvendësojë partnerin e kahershëm, "Standard Chartered", si sponsor kryesor në pjesën e përparme të fanellës, duke nisur nga sezoni 2027/28. Marrëveshja besohet të jetë me vlerë më shumë se 349 milionë euro për pesë vjet, duke e bërë atë, sipas klubit, kontratën më të vlefshme të sponsorizimit në historinë e Ligës Premiere.



Në fillim të këtij viti, Liverpooli është bërë për herë të parë klubi

anglez me të ardhurat më të larta, sipas "Football Money

League" të Deloitte, duke generuar plot 818 milionë euro të ardhura. Kontrata prej rreth 70 milionë eurosh në sezon me "Standard Chartered" ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë rritje, ndërsa eksperti i financave, Kieran Maguire, ka përmendur zgjerimin e "Anfield"-it dhe organizimin e eventeve jashtë futbollit si faktorë të rëndësishëm. "Është çështje e sjelljes se më shumë njerëzve në stadium dhe organizimit të më shumë eventeve aty. Ata kanë prituri koncerte dhe kanë përfituar të ardhura edhe nga

këto aktivitete. Ata gjithashtu kanë zgjeruar aktivitetet e dyqaneve të tyre zyrtare në mbarë botën, gjë që sjell të ardhura shtesë", kishte thënë ai. "Standard Chartered" ka qenë partneri kryesor i Liverpoolit që nga viti 2010, por nga sezoni 2027/28 do të kalojë në rolin e partnerit global. Kështu do të vazhdojë një prej partneriteteve më jetëgjata në futbollin botëror. "Ky njoftim është gjithashtu një mundësi për ta vlerësuar kontributin e jashtëzakonshëm që Standard Chartered ka dhënë për Liverpoolin gjatë 17 viteve të fundit", ka thënë Latty.

Ramadani ftohet nga Shqipëria për Ligën e Kombeve

TIRANË, 8 SHTATOR - Mesfushori Ylber Ramadani është ndër futbollistët e parë që është ftuar nga selektori i Kombëtares së Shqipërisë, Rolando Maran, për ndeshjet e këtij muaji. Në fund të këtij

muaji, Shqipëria do ta nisë rrugëtimin e saj në Ligën C të sezonit të ri të Ligës së Kombeve dhe do t'i zhvillojë dy përballje. Ftesa e Ramadaniit nga Shqipëria është konfirmuar

nga Çorumi, klubi ku ai luan në elitën e futbollit turk. Çorumi ka konfirmuar me krenari ftesën zyrtare për Ramadaniin, i cili te kjo skuadër është transferuar gjatë afatit kalimtar të verës nga

Lecce. 30-vjeçari ka 50 paraqitje me Shqipërinë, e cila më 26 shtator do të përballlet me Bjellorusinë në shtëpi, ndërsa tri ditë më vonë do të luajë në udhëtim ndaj San Marinos.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 1349/1
Datë: 08.09.2026

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së miratuar nga AAAPARr të dt. 04.09.2025 me nr. 848 nga **QK”Shtjefën Gjeçovi” - Prishtinë** shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maurantëve të QK”Shtjefën Gjeçovi” - Prishtinë, në Republikën e Shqipërisë

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t’i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfort dhe me klimë.
- Agjencionin duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencionin duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencionin duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencionin turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencionin duhet të ketë një dëshmi për marreveshje me hotelin ku planifikohet vendosja dhe akomodimi i nxënësve, sipas vendimit të KDSH- së të përcaktuar me datë 03.09.2026 dhe nr. 847. KDSH ka përcaktuar datat nga 30.09.2026 deri më 03.10.2026 - tre net, dhe për arsye sigurisë së nxënësve preferon vendosjen në hotel e kategorisë me pesë yje.
- Agjencionin duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencionin turistik duhet t’i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencionin duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t’i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencionin duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencionin do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2023-2024-2025)
- Agjencionin duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencionin duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Agjencionin duhet të ofrojë dëshminë me shkrim nga Hoteli se ka rezervuar vendosjen e nxënësve për datat e caktuara nga KDSH.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose të noterizuara!

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pavaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencionin të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Durrës, Krujë, Vlorë etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
 - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
 - Menyja
 - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
 - Gjendja teknike e autobusëve
 - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t’i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërtesa MASH II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë) Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë (ditën e fundit dokumentet pranohen deri në ora 14:00) nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT – Nr.01/2024 për Regullimin e Porcedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 pika 1,2 dhe 3 e Regullores nr.167 të datës mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve, pika 9 e nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Vendimit Nr.206 i datës 07.09.2026 U.D. Kryeshefi Ekzekutiv, N.P.L.”Stacioni i Autobusëve”Sh.A.,Gjakovë, shpallë këtë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

I.Pozita e punës: Administrator/e

Numri i pozitave: 1(Një)

Kohëzgjatja e punës: Kohë të pacaktuar (ndërsa puna provuese në kohëzgjatje prej 6muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon drejtëpërsëdrejtë aktet e dërguara nga persona e tjerë juridik dhe fizik;
- Përcjellë me protokoll dhe në librat e caktuar sipas dispozitave të të gjitha akteve në gjuhën në të cilën janë përpiluar dhe përmes librit intern përcjellës në Pajtim me sinjaturën, të cilën e ka caktuar udhëheqësi i Shërbimit për çështje të përgjithshme juridike;
- Bën sistemimin dhe arkivimin e dokumentacioneve të tyre;
- U përgjigjet kërkesave të parashtruara më herët nga punëtorët, operatorët dhe palët e treta;
- Mban evidencë e të punësuarve në Ndërmarrje;
- Kryen shërbime për të punësuarit në Ndërmarrje siç janë: Kalkulimi i Stazhitt ë punës dhe pushimeve sipas Ligjit.
- Sipas nevojës kryen dhe punë të tjera nga fushëveprimi i punës së vetë;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Sekretarit të Ndërmarrjes dhe KE.

Kualifikimet

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të kenë së paku 2 vite përvojë pune;
- Të jetë i aftë për punë me presion dhe të ketë shkathhtësi në kordinimin e punëve rutinore;
- Të jetë komunikues dhe të njoh ndonjë gjuhë të huaj(përparësi);
- Njohja e punës me programe kompjuterike.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Formular aplikimi i plotësuar;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional mbi shkollimin;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Kopjen e Letërnjoftimit;
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, Stacioni i Autobusëve në Gjakovë dhe përmes postës elektronike në e-mail adresën zyrtare **nplsagj@gmail.com**, Aplikacionet të dorëzohet në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora **08:00** deri në ora **16:00**.

- Vlefshmëria për aplikim zgjat **15 Ditë** duke filluar nga data e publikimit të Konkursit, gjegjësishtë mbyllet me date **21.09.2025** ditë e Hënë në ora **16:00**.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues ose ndonjë mjet të disponueshëm kontaktues.

Vërejtje: Të cektet qartë titulli i vendit të punës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e Lartë për Rregullativë dhe Standardizim
Grada: P05
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
Divizioni: Divizioni për Rregullativë dhe Standardizim
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Harton, harmonizon dhe interpreton kornizën ligjore dhe rregullative për institucionet financiare në vazhdimësi dhe në mënyrë korrekte;
- Rishikon dhe përmirëson vazhdimisht kornizën rregullative për institucionet financiare, për të qenë në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare;
- Ndihmon në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm metodologjik dhe praktik të modelit të mbikëqyrjes së institucioneve financiare në funksion të standardizimit të tij;
- Jep opinione sipas kërkesave të ndryshme që vijnë nga institucionet financiare lidhur me zbatimin e kuadrit rregullativ brenda kompetencave dhe funksionit të Departamentit;
- Ndihmon në hartimin akteve nënligjore, udhëzuesve dhe metodologjisë, në funksion të përmbushjes së objektivave për rimëkëmbjen dhe përmbylljen e bankave;
- Hulumton dhe analizon Direktivat e BE-së si dhe standardeve e pranua ndërkombëtare (Basel, ICP e të ngjashme), për mbikëqyrje financiare;
- Përcjell zhvillimet dhe praktikat ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare, adaptimi i të cilave është kërkesë për autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të BE-së;
- Përpilon metodologji për implementimin e Standardeve të pranua ndërkombëtare dhe analizon ndikimin e këtyre standardeve në sistemin financiar të vendit;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
- Përgatit raporte mbi kornizat ligjore dhe rregullative të aplikueshme të mbikëqyrjes financiare;
- Përgatit raportet e rregullta dhe të posaçme (ad-hoc raporteve) për çështjet që lidhen me Divizionin për Rregullativë dhe Standardizim;
- Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit dhe Drejtori i Departamentit.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë apo drejtësisë;
- Preferohet të ketë certifikime nga fushat e përmendura më lartë;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në sektor financiar ose përvojë në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim sipas përshkrimit të publikuar në këtë shpallje si dhe uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e mbikqyrjes financiare - BQK](#).

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi analitike të gjykimit për të vlerësuar dhe zbatuar legjislacionin ne fuqi dhe për të rekomanduar veprime të mëtutjeshme;
- Aftësi për të krijuar dhe mirëmbajtur marrëdhënie të mira profesionale me kolegët si dhe me palët e jashtme;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e caktuara kohore;
- Aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme;
- Shkathhtësi të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetinitativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim.** Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Letrën përcjellëse (motivuese)** e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim.
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku tre (3) vite përvojë pune** (kopje të kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse**, e cila mbulon së paku tre (3) vite përvojë pune, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht.
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it.
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim **24 shtator 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Nasalov radnog mesta: Viši Službenik za Regulativu i Standardizaciju
Stepen: P05
Trajanje zaposlenja: na neodređeno vreme
Departman: Departman za Licenciranje i Standardizaciju
Odsek Odsek za za Regulativu i Standardizaciju
Izveštava: Odseku za Regulativu i Standardizaciju

Glavne Dužnosti i Odgovornosti:

- Kontinuirano i pravilno izrađuje, uskladuje i tumači pravni i pravni okvir za finansijske institucije;
- Preispituje i kontinuirano unapređuje regulatorni okvir za finansijske institucije, kako bi bio u potpunosti u skladu sa međunarodnim standardima;
- Pomaže u procesu kontinuiranog metodološkog i praktičnog unapređenja modela nadzora finansijskih institucija radi njegove standardizacije;
- Daje mišljenja prema različitim zahtevima koji stižu od finansijskih institucija u vezi sa implementacijom regulatornog okvira u okviru nadležnosti i funkcija Departmana;
- Pomaže u izradi podzakonskih akata, smernica i metodologija, kako bi se ispunili ciljevi za oporavak i zatvaranje banaka;
- Istražuje i analizira direktive EU-a, kao i međunarodno prihvaćene standarde (Basel, ICP i slično), za finansijski nadzor;
- Prati međunarodni razvoj i praksu finansijskog nadzora, čije je usvajanje uslov za nadzorne vlasti država članica EU-a;
- Sastavlja metodologije za implementaciju međunarodno prihvaćenih standarda i analizira uticaj ovih standarda na finansijski sistem zemlje;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama Departmana;
- Priprema izveštaje o primenljivim pravnim i regulatornim okvirima finansijskog nadzora;
- Priprema redovne i posebne izveštaje (ad-hok izveštaje) o pitanjima koja se odnose na Odsek za Regulativu i Standardizaciju;
- Obavlja sve ostale poslove koje mu dodeli Rukovodilac odseka i Direktor Departmana.

Potrebno akademsko i stručno znanje:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije ili prava;
- Poželjno je da ima sertifikate (potvrde) iz gore navedenih oblasti;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno stručno iskustvo:

- Da ima najmanje tri (3) godine stručnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti vezanoj za odgovornosti Odseka za Regulativu i Standardizaciju prema opisu objavljenom u ovom oglasu i na veb stranici CBK-a kao na linku: [Departmani Finansijskog Nadzor - CBK](#).

Specifični zahtevi:

- Analitičke sposobnosti da procenjuje i primenjuje važeće zakonodavstvo i preporučuje dalje akcije;
- Sposobnost uspostavljanja i održavanja dobrih profesionalnih odnosa sa kolegama i eksternim stranama;
- Sposobnost da radi pod pritiskom i poštuje rokove;
- Sposobnost za rešavanje problema prema prioriteta;
- Odlično poznavanje u korišćenju računarskih sistema, MS Office-a i slično;
- Dobre komunikacijske i prezentacijske veštine;
- Lice sa visokim etičkim karakteristikama i sposobnošću čuvanja profesionalne poverljivosti;
- Pažnja posvećena detaljima, jasne formulacije i tačnost;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Da ima tačno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu.** Prijave koje ne popune u potpunosti i ispravno zvanični Obrazac CBK-a tokom prijavljivanja online neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Motivaciono pismo** koje mora biti adresirano (upućeno) i pripremljeno posebno za poziciju za koju se prijavljuju; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana.
- Dokaz o radnom iskustvu, koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje zauzete pozicije i radnog iskustva,bez obzira na relevantne zakone za zaštitu ličnih podataka).
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog fonda (Trusta) za relevantni period, koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva**, ili poreska potvrda iz Poreske Administracije (PAK) kada izveštaj iz Trust-a nije pravno primenljiv.
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a.
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura za prijavljivanje:

- Krajnji rok za prijavljivanje je **24. septembar 2026**.
- Prijava se može podneti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a. Drugi oblici (načini) prijavljivanja neće se uzeti u obzir.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Erulas” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812294875 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Erulas” L.L.C. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812294875 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Erulas” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812294875 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

